

20190270370

## LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

### Neni 1

Në Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 248/18) neni 44 ndryshohet si vijon:

### "Neni 44

Planin financiar për vitin 2019 RTM është i detyruar që ta dorëzojë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë më së voni në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji."

### Neni 2

Neni 46 ndryshohet si vijon:

### "Neni 46

(1) Deri në ditën e miratimit të rregullave të përcaktuara me nenin 35 paragrafët (3) dhe (4) me të cilin bëhet ndryshimi i nenit 143 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 248/18), përkatësisht në afat prej 60 ditësh nga zgjedhja e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në pajtim me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 248/18), operatorët që ritransmetojnë servise programore të radiodifuzerëve vendorë dhe të huaj vazhdojnë t'i ritransmetojnë serviset programore të radiodifuzerëve vendorë dhe të huaj në mënyrë dhe në kushte të përcaktuara në nenin 143 të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17 dhe 168/18).

(2) Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ka për detyrë t'i publikojë aktet nënligjore nga paragrafi (1) i këtij neni dhe para miratimit të tyre të organizojë debat publik.

(3) Dispozitat e nenit 35 paragrafët (3) dhe (4) me të cilin bëhet ndryshimi i nenit 143 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 248/18), hyjnë në fuqi 60 ditë nga dita e zgjedhjes së Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të zgjedhur në pajtim me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 248/18). "

### Neni 3

Pas nenit 46 shtohen dy nene të reja 46-a dhe 46-b, si vijojnë:

### "Neni 46-a

Marrëveshjet e organeve shtetërore, organeve të administratës shtetërore, ndërmarrjeve publike, njësive të vetëqeverisjes lokale, institucioneve publike si dhe personave juridikë me autorizime publike dhe shoqërive tregtare në pronësi të plotë të shtetit të lidhura në bazë të nenit 102 të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17 dhe 168/18), mbesin

në fuqi deri në skadimin e vlefshmërisë së tyre, ndërsa pas skadimit të tyre organet shtetërore, organet e administratës shtetërore, ndërmarrjet publike, njësitë e vetëqeverisjes lokale, institucionet publike si dhe personat juridikë me autorizime publike dhe shoqëritë tregtare në pronësi të plotë të shtetit, janë të obliguar ta harmonizojnë punën e vet me nenin 25 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 248/18).

#### Neni 46-b

Marrëveshjet e RTM-së të lidhura në bazë të nenit 105 paragrafi (1) të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17 dhe 168/18), mbesin në fuqi deri në skadimin e vlefshmërisë së tyre, ndërsa pas skadimit të tyre RTM-ja është e obliguar ta harmonizojë punën e vet me nenin 27 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 248/18).”.

#### Neni 4

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele.

#### Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.